



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura V  
Sesioni vjeshtor

Seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit  
S-048  
Prishtinë, më 17 nëntor 2015,

**PROCESVERBAL**

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 17 NËNTOR 2015**

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të procedohet me rendin e ditës, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës tentuan të dalin para foltores së Kuvendit për ta penguar mbajtjen e seancës plenare, por pjesëtarët e sigurimit i pengun ata që depërtojnë në drejtim të kryesuesit të seancës.

Kryetari kërkoi nga deputetët e grupeve parlamentare të opozitës që të mos e pengojnë mbajtjen e seancës, por qëndrimet e tyre t'i paraqesin në seancë.

Kryetari kërkoi nga deputetët e grupeve parlamentare të opozitës që të deklarohen për mbajtjen e seancës.

Kryetari i Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, dhe ai i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, u deklaruan se seanca duhet të mbahet.

Mirëpo, deputetët e grupeve parlamentare të opozitës vazhduan ta pengonin mbajtjen e seancës, ndërsa njëri nga radha e tyre hodhi gaz lotsjellës në sallën e seancave, kurse deputeti Albin Kurti hodhi sprej në drejtim të Kabinetit qeveritar.

Në këto rrethana, kryetari dha pauzë dhe e thirri mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare.

\* \* \*

Pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit në Kabinetin e kryetarit të Kuvendit, seanca i vazhdoi punimet në sallën alternative, në katin e katërt.

Kryetari i njoftoi deputetët se për shkak të gjendjes së krijuara në sallën e seancave plenare, pas hedhjes së gazit lotsjellës, Kryesia e Kuvendit ka vendosur që seanca t'i vazhdojë punimet në sallën alternative.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i përshëndeti përfaqësuesit e misioneve diplomatike dhe të medias, që ishin të pranishëm në sallë.

Para se të procedohet me rendin e ditës, për fjalë u paraqitën kryeministri dhe zëvendëskryeministri i Kosovës.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa shprehu papajtueshmërinë e Qeverisë së Republikës së Kosovës me sjelljen e opozitës në seancën e sotme të Kuvendit. Kjo që ndodhi sot, theksoi ai, është akt kriminal i individëve, për të cilin institucionet e Republikës së Kosovës duhet të marrin masa. Ata që sulmojnë, që hedhin gaz lotsjellës, që hedhin masa kimike, me të cilat e cenojnë shëndetin dhe jetën e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, edhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përfaqësuesve diplomatikë në Kuvend, duhet të përgjigjen para ligjit.

Zëvendëskryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, tha se përsëri sot, mbi 80 deputetë, 2/3 e Kuvendit të Republikës së Kosovës, u ballafaquam me sulm kundër koalicionit qeverisës për ta penguar punën dhe funksionimin e Kuvendit të Kosovës. Ne jemi të zgjedhurit për ta implementuar agjendën tonë shtetërore, siç është edhe sot Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin e ardhshëm.

Sot, sulmi nuk ishte vetëm gaz lotsjellës, por ishte helm drejtuar deputetëve dhe Kabinetit qeveritar. Ne do të vazhdojmë dhe askush nuk do të mund ta bllokojë Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe toleranca ndaj veprimeve të dhunshme dhe kriminale duhet të jetë zero.

Deputetja Melihate Tërmkolli kërkoi nga kryetari i Kuvendit, nga Qeveria e Kosovës dhe nga të gjitha institucionet tjera përgjegjëse që t'i funksionalizojnë institucionet e shtetit të Kosovës. Kosova ka mbajtur këso takimesh vetëm kur ka qenë e pushtuar. Në Kosovën shtet i lirë i pavarur e demokratik, këto veprime janë të papranueshme, të dënueshme, të cilat shteti i Kosovës më nuk duhet t'i lejojë.

\* \* \*

Pas këtyre diskutimeve, kryetari procedoi me pikën e rendit të ditës:

## **1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016**

Kryetari i njoftoi deputetët se kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Isa Mustafa, në bazë të nenit 69.4 të Kushtetutës dhe të nenit 38.2 të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Para se të procedohet me shqyrtimin e Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa që ta paraqesë propozimin e Komisionit Funkcional që shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet me shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Kryetari i Komisionit, Naser Osmani, tha se më 4 nëntor 2015 Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka mbajtur mbledhjen në të cilën e ka shqyrtuar buxhetin dhe ka ardhur në përfundim që të kërkohet nga Kryesia e Kuvendit shmangia nga Rregullorja që me procedura të përshpejtuara ta miratojmë Ligjin e buxhetit edhe në leximin e dytë në javën e parë të dhjetorit, konform marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Kryetari kërkoi deklarinimin e kryetarëve të grupeve parlamentare që të deklarohen për propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Kryetarët e grupeve parlamentare: Adem Grabovci i GP të PDK-së, Ismet Beqiri i GP të LDK-së, Slavko Simiq i GP të LS dhe Fikrim Damka i GP “6+” deklaruan se e mbështetin propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 79,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

## V E N D I M

**I.** Për shmangie nga afatet procedurale të parapara më nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 , si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 bëhet në seancën plenare më 17 nëntor 2015.
2. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 të bëhet më së voni deri më 9 dhjetor 2015.

**II.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Pas miratimit të këtij vendimi, kryetari e ftoi ministrin e Financave që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektbuxhetin e vendit për vitin 2016.

Ministri i Financave, Abdullah Hoti tha se Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 adreson objektivat zhvillimore të Qeverisë së Republikës së Kosovës të prezantuar në Programin qeverisës.

Hartimi i projektligjit ka marrë parasysh ruajtjen e qëndrueshmërisë fiskale, të cilën e kemi ndërtuar gjatë këtij viti dhe financimin e prioriteteve të Qeverisë brenda kufizimeve që kemi pasur.

Ne presim që në vitin 2016 rritja ekonomike të jetë 3,8%, ndërsa për tre vjetët e ardhshme mesatarisht do ta kemi një rritje ekonomike prej 4,2%.

Ne presim që investimet të rriten mesatarisht me nga 10% dhe të shkojnë rreth 27% e bruto-prodhimit vendor, së bashku me investimet private dhe ato publike. Ne presim që eksportet të rriten me rreth 7%, duke e zvogëluar deficitin tregtar me kalimin e viteve. Ne presim që konsumi të rritet me vetëm 3,5%, pasi do të fillojë të mbulohet me prodhimin vendor.

Të hyrat për vitin 2016 i kemi planifikuar në nivel prej 1 miliard e 598 milionë euro, që është një rritje prej 4,1% krahasuar me këtë vit dhe është një rritje prej 19% krahasuar me vitin 2014. Të hyrat vendore presim që do të rriten me 8,8%, ndërsa ato nga Dogana me 6,2%.

Kjo rritje e të hyrave merr parasysh efektet e politikës fiskale që ka në Buxhetin e Kosovës nga lirimi i TVSH-së të importit të makinerive prodhuese dhe lëndëve të para dhe efektin që ka Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit me të hyrat buxhetore.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2016 do të jenë 1 miliard e 680 milionë euro, që është një rritje prej 2% në raport me këtë vit dhe 14% mbi shpenzimet e realizuara të vitit 2014. Ne i kemi racionalizuar shpenzimet dhe me këtë racionalizim dhe me rritje të të hyrave shtesë është bërë e mundur që këtë buxhet të përfshijmë një rritje prej 25% për asistencë sociale për 17 mijë familje që janë në këtë skemë për zbatimin e plotë të Ligjit për skemat e financuara nga shteti me një buxhet shtesë prej 23 milionë krahasuar me buxhetin e këtij viti për t'i kategorizuar këta pensionistë dhe për t'i futur në zbatim dy skema të reja pensionale - ato të pensionit familjar dhe të pensionit invalidor, është ndarë buxhet i mjaftueshëm për ta paguar përvojën e punës, që kushton rreth 30 milionë euro për 80 mijë të punësuar në sektorin publik. Do të vazhdojë mbështetja për bujqësinë, siç ka qenë edhe këtë vit, dhe janë siguruar rreth 25 milionë euro shtesë për pensionet e veteranëve dhe të kategorive tjera të dala nga lufta.

I kemi akomoduar obligimet që kemi si shtet i Kosovës ndaj marrëveshjeve ndërkombëtare, që janë rreth 6 milionë. E kemi rritur buxhetin për organet e drejtësisë prej 13% për prokurori dhe për gjyqësi me 6%. E kemi rritur buxhetin për 9% për Forcat e Sigurisë të Kosovës, për modernizimin dhe përmbushjen e standardeve.

Buxheti për shpenzime kapitale do të jetë 463 milionë euro dhe mundëson financimin e 39 shkollave dhe anekseve shkollore në mbarë vendin, ndërtimin e objekteve për universitetet e reja në Mitrovicë, Gjiçan, Gjakovë dhe në Pejë. 25 objekte sportive, 4 qendra rinore, 24 objekte të ndryshme në fushën e shëndetësisë primare, sekondare dhe terciare, janë 15 objekte të kulturës dhe të artit, mbi 116 rrugë të ndryshme regjionale dhe lokale në tërë Kosovën. është financimi i plotë i autostradës Prishtinë - Hani i Elezit dhe projekteve që janë në vijim e

Propozimin e Qeverisë për financimin e Radiotelevizionit të Kosovës do ta paraqesim gjatë shqyrtimit të projektligjit, pas miratimit në parim, në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në komisionin përkatës për Media me një zgjidhje afatshkurtër të financimit të RTK-së dhe jemi të gatshëm ta mbështetim Kuvendin dhe komisionin parlamentar për zgjidhjen afatgjatë për financimin e Radiotelevizionit të Kosovës.

Kryeministri Isa Mustafa i prezantoi orientimet themelore të Qeverisë së Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me Projektligjin për Buxhetin.

Ekziston mundësia që në bazë të Marrëveshjes të me Fondin Monetar Ndërkombëtar të bëjmë ndërhyrje dhe me investime kapitale në të gjitha ato fusha ku sigurojmë se ato investime do ta rritin ekonominë dhe do të sigurojnë punësim të ri.

Projektligji për Buxhetin është një prej vendimeve prej të cilit ne në mënyrë të drejtpërdrejtë e përcaktojmë perspektivën tonë zhvillimore për vitin 2016. Ne si Qeveri e kemi përcaktuar zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës, luftën kundër evazionit fiskal, kontrabandës, krimit të organizuar, korrupsionit dhe integrimin tonë euroatlantik, kultivimin e partneritetit me miqtë tanë ndërkombëtarë si prioritet tona.

Ne presim që brenda këtij viti, në bazë të dhënave që i kemi nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, nga Banka jonë Qendrore, nga bankat ndërkombëtare dhe institucionet e tjera financiare, por edhe nga Agjencia e Statistikave ta kemi një rritje mesatare ekonomike prej rreth 3%. Ndoshta kjo rritje do të jetë edhe më e madhe se kjo dhe mendojmë se kjo rritje pastaj na mundëson që në vitin 2016 ta shtojmë rritjen tonë ekonomike, sidomos në fushat në të cilat ne u kemi dhënë prioritet dhe kjo është në rend të parë fusha e bujqësisë, e cila siguron punësim më intensiv.

Është energjetika, për të cilën ne tani po zhvillojmë biseda me një konsorcium të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe jemi afër marrëveshjes për ndërtimin e Termocentralit “Kosova e Re”, me të cilën ne do të sigurojmë energji elektrike për ekonominë dhe për qytetarët. Pastaj është një projekt shumë i rëndësishëm i Brezovicës si investim i jashtëm dhe po ashtu po punojmë mjaft shumë që të tërheqim investitorë të jashtëm edhe në fushat e tjera, sidomos të zhvillimet minerare dhe të shfrytëzimit të minierave si resurse shumë të rëndësishme të vendit tonë.

Ne e kemi nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim-Asociim dhe konsideroj se është një prej marrëveshjeve tepër të rëndësishme, e cila hap mundësinë e zhvillimit tonë.

Ne nuk dëshirojmë që buxheti të shtohet nëpërmjet rritjes së normave të tatimeve dhe taksave, ose normave të kontributeve të ndryshme, mirëpo ky buxhet të shtohet duke e ulur evazionin fiskal dhe duke e zgjeruar bazën tatimore, duke e përfshirë një numër më të madh të taksapaguesve dhe po ashtu duke e bërë rritjen ekonomike nëpërmjet së cilës do të mundësojmë që ne ta krijojmë një konvergjencë të domosdoshme ndërmjet politikave fiskale dhe politikave zhvillimore.

Ne presim që nga instrumenti për anëtarësim IPA do ta kemi diku një përkrahje rreth 600 milionë euro deri në vitin 2020, të cilën do ta adresojmë për vitet e caktuara deri atëherë dhe e cila është një mbështetje shumë e rëndësishme edhe zhvillimore për vendin tonë.

Pas këtyre prezantimeve, kryetari hapi diskutimin për projektbuxhetin e vendit për vitin 2016.

Për Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 diskutuan: në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani; në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Labinotë Demi-Murtezi; në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Naser Osmani; në emër të Grupit Parlamentar Lista serbe, Slavko Simiq; në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, si dhe deputetët: Muhamet Mustafa, Zenun Pajaziti, Emilija Rexhepi, Vjosa Osmani-Sadriu, Gëzim Kelmendi dhe Shaip Muja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas përfundimit të diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 71,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.
2. Kërkohet nga Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa dhe nga komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me vendim të seancës plenare, të mbajtur më 17 nëntor 2015, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari i mbylli punimet e seancës në orën 10:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*E përgatiti:*  
*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*